



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.135/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konusheci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR dega në Besianë, për shkak të vendosjes së flamujve në shtylla elektrike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.135/2017 e dates 07.06.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje dega në Besianë, me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017 në rrugën “Zahir Pajaziti” në Besianë, aktivisti i tyre ka vërejtur se nëpër shtylla elektrike ishin vendosur flamujt të Koalicionit LDK-AKR.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicioni LDK-AKR, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 08.06.2017, Koalicioni LDK-AKR thekson se pas pranimit të Urdhërit për Përmirësim kanë kërkuar nga kandidati dhe dega në Besianës për të ndërmarrur veprime përmirësuar, mirëpo kandidati i dhe dega në Besianë ka konfirmuar se nga kuvendi komunal i Besianës kanë marr leje për të vendosur flamujt, banerët dhe billbordet e koalicionit LDK-AKR.

Lidhur me përgjigjen në ankesë pala i ka bashkangjitur kopjen e kërkesës vendimit për lejimin e shfrytëzimit të hapësirave publike si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

ankesa është e pabazuar

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit LDK-AKR, nuk është bërë shkelja e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që materiali flamujt e koalicionit LDK-AKR, janë të vendosur pikërisht në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të flamujve.

Paneli gjatë shqyrtimit të ankesës mori për bazë pretendimet e theksuara në përgjigje në ankesë nga Koalicioni LDK-AKR se Kuvendi Komunal i Besianës i ka lejuar për shfrytëzim hapësirën publike (shtyllat e ndriçimit elektronik) me vendimin Nr. 10-007-710 të datës 01.06.2017 për e vendosjen e flamujve të koalicionit LDK-AKR si dhe banerët e billbordat në vende ku nuk pengojnë, dhe se pas përfundimit të fushatës zgjedhore obligohet koalicioni në fjalë që të bëjnë largimin e të materialit zgjedhor nga hapësira publike dhe të njejtën ta kthejë në gjendje të më parshme.

Mbi këtë bazë paneli konsideron se koalicioni në fjalë nuk ka kryer shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.135/2017 më datën 09.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.